

2023



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA E RAHOVECIT - OPŠTINA ORAHOVAC
Drejtoria për Administratë të përgjithshme
Odeljenje za Opštu Upravu

-III-

Nr. I prot

Br. prot.

1403

Më

Dt.

05.04.2023

RAHOVEC - ORAHOVAC

PLANIFIKIM TREMUJOR I PUNËS

PRILL – QERSHOR

DREJTORIA PËR PUNË INSPEKTUESE

KOMUNA E RAHOVECIT

PËRMBAJTJA

BAZA LIGJORE	2
QËLLIMET E INSPEKTIMIT	2
AKTIVITETET E INSPEKTIMEVE.....	2
ORGANIZIMI DHE PLANI INSPEKTUES	3
OBJEKTIVAT DHE AKTIVITETET	3
PËRFUNDIM	4



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo




Komuna e Rahovecit

Opština Orahovac/Municipality Rahovec

Drejtoria Për Punë Inspektuese/Odeljene Za Pozlove Inspekcije /Department Of Inspection

DATË /A:	05.4.2023
PËR/ZA/TO:	z. Smajl Latifi - Kryetar i Komunës
CC:	z.Ali Morina – Shef i Kabinetit
NGA/OD/FROM:	znj. Nora Boshnjaku – Drejtoreshë e Drejtorisë për Punë Inspektuese
LËNDA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Planifikim tremujor i punës



BAZA LIGJORE

Planifikimi tremujor i Drejtorisë për Punë Inspektuese, për muajt prill - qershor 2023, bazohet në Planin Vjetor të Punës për vitin 2023; dispozitat që dalin nga: Ligji për Vetëqeverisjen Lokale, Ligji për Inspektoratin e Tregut 03/L-181 dhe Ligjin 04/L-186 për Plotësim Ndryshimin e Ligjit 03/L181, Ligji 04/L-175 për Inspektoratin e Ujërave, Natyrës, Planifikimit dhe të Ndërtimit, Ligjit nr. 04/L-179 Për Transportin Rrugor, Statutin e K.K. Rahovec si dhe akte tjera ligjore.

QËLLIMET E INSPEKTIMIT

Qëllimet e inspektimit arrihen nëpërmjet:

- Respektimi i parimeve ligjore;
- Respektimit të kërkesave ligjore nga subjekti i Inspektimit;
- Këshillimi i subjektit të inspektimit për zbatimin sa më korrekt të kërkesave ligjore;
- Urdhërimi për korrigjim të shkeljeve ligjore dhe eliminimin e pasojave që dalin prej tyre;
- Shqiptimi i dënimeve, marrja e masave tjera administrative;

AKTIVITETET E INSPEKTIMEVE


Aktivitete inspektuese për realizimin e objektivave të inspektimit janë:

- Inspektimi i veprimtarive-subjekteve afariste të cilat janë subjekt i inspektimit;
- Përgjigjja në kërkesa zyrtare dhe trajtimi i rasteve ad-hoc;
- Përpilimi i procesverbaleve, nxjerrja e vendimeve dhe akteve tjera dhe ekzekutimi i tyre;

ORGANIZIMI DHE PLANI INSPEKTUES

Gjatë muajve prill - qershor në Drejtorinë për Punë Inspektuese, inspektimet planifikohet të realizohen në tërësi duke e mbuluar territorin e Komunës së Rahovecit, - DPI do të jetë e organizuar në grupe inspektuese me nga 4 grupe të kombinuara sipas nevojës. Inspektimi në terren rregullisht fillon nga ora: 9:00: - 14:00, ndërsa sipas rrethanave dhe kërkesave mund të zgjasë edhe më shumë.

OBJEKTIVAT DHE AKTIVITETET



AKTIVITETET E PLANIFIKURA PËR MUAJT PRILL, MAJ QERSHOR

- Ndërprerja e të gjitha ndërtimeve pa leje;
- Kontrollimi sistematik i objekteve me leje;
- Inspektim final i objekteve ndërtimore;
- Rrënimi i objekteve pa leje;
- Inspektime intensive në funksion të mbrojtjes së ambientit;
- Obligimi i bizneseve për t'u pajisur me leje për shfrytëzimin e hapësirës publike;
- Kontrollimi i sipërfaqeve të gjelbra publike;
- Mbikëqyrja e rrugëve rreth punishteve;
- Inspektim të transportit publik të udhëtarëve dhe mallrave;
- Inspektim i lokaleve afariste;
- Inspektim të dëmtimit të rrugëve;
- Inspektim të hapësirave publike etj.;
- Mbikëqyrja për kryerjen e rregullt të punëve, në përputhje me ligjin dhe aktet tjera;
- Përcjellja e gjendjes në kuadër të drejtorisë, identifikimi i problemeve dhe vështirësive, si dhe propozimi i masave për mënjanimin e tyre;
- Inspektim të lokaleve afariste, sa i përket kushteve sanitare dhe tejkalimit të orarit të punës;
- Aksione në vazhdimësi për largimin e shitësve ambulantë;
- Kontrollimi i terrenit;
- Obligim i subjekteve afariste për pajisje me leje mjedisore;
- Kontrole të vazhdueshme – verifikimi periodik i peshoreve në furra dhe markete;
- Verifikim i kushteve minimale- teknike dhe pajisja e subjekteve me pëlqim pune;

PËRFUNDIM

Përkundër të gjitha sfidave, ky plan për përmbushjen e të gjitha objektivave, nevojitet një bashkëpunim me të gjitha institucionet tjera të cilat do ta ndihmonin arritjen e rezultateve konkrete.

Ky plan pune mund të plotësohet edhe me objektiva dhe detyra tjera të cilat mund të jenë të nevojshme, si dhe me kërkesën dhe vendimin e Kryetarit të Komunës, varësisht nga nevojat dhe prioritetet që mund të shfaqen gjatë periudhës planifikuese, për përmbushjen e këtij plani.

Me respekt!